



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Datë 01-07-2026			
Nr. Llogarit (Gj. Broj)	Nr. Broj	Subjekti Projeq	Vlera Vendnost
12-	039/02-	662	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Arian Alidema(anëtar), Bashkim Sadiku (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 01.07.2026, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ AKV Vitia” me Nr.12-320/04-19355, e datës 26.06.2026, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e OJQ AKV Vitia” me Nr.12-320/04-19355, e datës 26.06.2026, e përfaqësuar nga z.Enver Osmani nga Vitia, kundër Vendimi të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026.
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026.

A r s y e t i m

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 01.07.2026 shqyrtoj ankesën e OJQ AKV Vitia” e përfaqësuar nga z.Enver Osmani nga Vitia me Nr.12-320/04-19355, e datës 26.06.2026, kundër Vendimit të listës preleminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026., të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për paknaqësinë sepse e njëjta nuk është përkrahur me mjete financiare pra është refuzuar me arsyetim se e njëjta nuk ka dorëzuar, përmbyllur raportin financiar për vitin 2024, i njëjti kërkon të rishqyrtohet aplikacioni, merren parasysh rrethanat faktike dhe se OJQ AKV Vitia nuk ka përvetsuar apo keqpërdor subvencionet etj.me përkrahjen që i është bërë në lidhje me shumën financiare të miratuar nga komisioni vlerësues.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstaton se, ankësa e OJQ AKV Vitia **është e pabazuar**, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 30.06.2026 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ AKV Vitia, Thirrjen Publike .02-118/02-336, Vendimin preliminar të komisionit vlerësues, Vendimin përfundimtar për Subvencione të OJQ-ve për vitin 2024, Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 3.000 euro nr.02-035/02-852 datë 03.06.2024 të kryetarit të Komunës, Konstatimet për raportet e OJQ-ve për vitin 2024 të Komisionit të formuar sipas vendimit të kryetarit të Komunës nr.02-035/02-1179 datë 08.10.2024..
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës e OJQ AKV Vitia Nr.12-320/04-19355, e datës 26.06.2026 konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve

të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

- Komisioni vlerësues ka respektuar nenin 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikuesve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform nenit të cekur më lartë.
- Komisioni i ankesave konsideron dhe vlerëson se komisioni për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësuar e analizuar aplikacionin e OJQ AKV Vitia ka vendosur drejt, sipas thirrjes publike, buxhetit të Drejtorisë së DKRS-ë për vitin 2026, duke refuzuar përkrahjen për vitin 2026 sepse e njëta nuk ka dorëzuar raportet narrative për vitin 2024 ashtu siç parashihet në Kontratën e nëshkruar dhe e njëta është në kundërshtim me Thirrjen për vitin 2026 ashtu siç theksohet në Vërejtje “Organizatave të cilat nuk i kanë përmbyllur projektet e vitit paraprak Raportet Financiare dhe Narrative nuk do të mbështeten financiarisht “ bazuar në nenin 11 paragrafi 2, dhe duke pasur parasysh dispozitat e nenit 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 “të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet e financimit” sipas Rregullores 04/2017 dhe është në diskrecionin e komisionit vlerësues mbështetja financiare bazuar në aplikacionin dhe aktivitetet e parapara të OJQ AKV Vitia.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kriteret të qarta, duke respektuar dyshkallëshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese –AKV Vitia, e përfaqësuar nga z.Enver Osmani.
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale;

Viti, më 01.07.2026

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Arian Alidema, anëtar

Bashkim Sadiku, anëtar

